



BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 49, datë 11.11.2015

Për

“MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I, shkronja “b”, nenit 8, pika 1/III, shkronja “b”, nenit 16 pika 3, shkronja “a”, nenit 32, shkronja “f” dhe nenit 33, pika 3 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 121 pika 1, 124 pika 1 dhe nenit 125 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 35 pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 19.06.2006 “Për miratimin e projektit për një sistem të ri parkimi për Tiranën”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit në Bashkinë e Tiranës dhe nënzonave të destinuara për parkim sipas Aneksit 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë zonat e administrimit të parkimit në qytetin e Tiranes dhe respektivisht nënzonat e destinuar për parkim sipas Aneksit 2 bashkëlidhur, për të vendosur Tirana Parking.
3. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të vlerësojë plotësimin e kushteve për shtrirjen e zonave të administrimit të parkimit (“ZAP”) në Bashkinë Tiranë, të ndjekë procedurat për plotësimin, përmirësimin ose shtimin nënzonave të destinuara për parkim (“NDP”) duke u bazuar në kritereve të përcaktuara në Aneksi 1 dhe t’i propozojë Këshillit Bashkiak miratimin e tyre.
4. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të rishikojë dhe përcaktojë një ndarje të re të zonave të administrimit të parkimit (“ZAP”) dhe respektivisht nënzonat e destinuara për parkim (“NDP”) nëse nuk përputherford me planet e transportit e qarkullimit dhe t’i propozojë Këshillit Bashkiak miratimin e tyre.

5. Të përcaktojë tarifat e shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës sipas Aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Pika 1/1.2, shkronja”c”, “*Tarifën e Parkimit të Automjeteve*” e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 05.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar) dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 03.02.2003, “*Mbi caktimin e vendparkimeve publike me pagesë ne qytetin e Tiranës*” (i ndryshuar) shfuqizohen.
7. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.01.2006 “Për përcaktimin e vendndodhjes së parkimeve me pagesë për shërbimin taksi (4+1), (8+1) dhe të mjeteve për transport të mallrave për të tretë në qytetin e Tiranës” shfuqizohet.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë dhe Tirana Parking.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I



ANEKSI NR. 1

Kriteret për përcaktimin e Zonave të Administrimit të Parkimit dhe nënzonimi i tyre

1. Zonat e administrimit të parkimit në territorin e Bashkisë së Tiranës ("ZAP") janë zonat që përfshihen në sistemin e kontrolluar të administrimit të parkimit nga Bashkia e Tiranës.
2. ZAP konsiderohen zonat që plotësojnë kriteret sipas:
 - a. **Përcaktimeve të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:** ku përfshihen të gjitha karakteristikat/normat teknike dhe funksionale që lidhen me përcaktimin e parkimit dhe ndërlidhjen e tij me elementët e rrugës ose jo.
 - b. **Masterplanit të Transportit:** ku përfshihen të gjitha elementët e planifikimit të transportit që krijojnë/mundësojnë realizimin e zonave/nënzonave të shërbimit të parkimit në ZAP.
 - c. **Planit të qarkullimit të mjeteve:** ku përfshihen të gjitha mundësítë që ofron plani i lëvizjes në raport me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.
 - d. **Kushteve të infrastrukturës rrugore:** ku përfshihen kushtet fizike të infrastrukturës rrugore, e rikonstruktuar ose e parikonstruktuar dhe lidhja e saj me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.
 - e. **Kategorizimeve të rrjeti rrugor dhe zonat jashtë rruge sipas shkallës/intensitetit të aktivitetit social ekonomik:**
 - (i) **Kategoria e 1** – Rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) që vlerësohen me aktivitet të dendur/intensiv social dhe ekonomik sidomos në rrugët me aktivitet tregtar, të njohura si rrugët/zonat tregtare sipas të dhënavë të grumbulluara nga arshiva e informacionit (GIS);
 - (ii) **Kategoria e 2** – Rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) që vlerësohen jo me aktivitet të dendur social dhe ekonomik dhe jo me aktivitet të dendur tregtar, por që kanë një intesitet mesatar të fushave të mësipërme sipas të dhënavë të grumbulluara nga arshiva e informacionit (GIS);
 - (iii) **Kategoria e 3** – Rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) që vlerësohen pa aktivitet social dhe ekonomik dhe me aktivitet të vogël/ose fare tregtar sipas të dhënavë të grumbulluara nga arshiva e informacionit (GIS).
 - f. **Kriteri i kërkesë/ofertës:** Disponibilitetin e hapësirave rrugore dhe zonave jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) për vendparkime vs. ofertës dhe kërkesës për parkim, sipas shkallës së zënies ku:
 - (i) **Kategoria 1.1**
 - a. Shkalla e zënies > 100% në momentet e pikut.
 - b. Shkalla e zënies > 100% në momentet e jopikut.

(ii) Kategoria 1.2

- a. Shkalla e zënies > 100% në momentet e pikut.
- b. Shkalla e zënies 80% deri në 100% në momentet e jopikut.

(iii) Kategoria 1.3


- a. Shkalla e zënies < 100% në momentet e pikut.
- b. Shkalla e zënies < 100% në momentet e jopikut.

1. ZAP-të detajohet në nënzonat. Detajimi identifikon nënzonat e destinuara për parkimin - në rrugë dhe/ose dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) - në zonat ZAP ("NDP").
2. NDP-të pa pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve përfshijnë:
 - a. parkim për rezidentët;
 - b. parkim i lirë pa roje ose pa sisteme kontrolli të kohëzgjatjes së qëndrimit (pa pagesë);
 - c. parkim i rezervuar për automjetet e personave me aftësi të kufizuar pa pagesë.
3. Kriteret për përcaktimin e NDP pa pagesë në rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
 - a. rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e personave me aftësi të kufizuar (PAK) dhe parkimit të lirë pa roja ose pa sisteme (PL) në një masë jo më e vogël se 5% e NDP
 - b. rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e banorëve (AB) ka si kriter vlerësimi kriteret që lidhen me kategorizimin e rrjetit rrugor dhe kërkesë/ ofertës ku ndërthurja e Kategorisë 3 të Rrjetit Rrugor dhe Kategorisë 1.3 të Kërkesë/Ofertës mundëson një rezervim:
 - (i) deri 70% të NDP në favor të (AB),
 - (ii) deri 30 % të NDP në favor të (PL) dhe (PAK).
4. Vlerësimi i NDP pa pagesë në raport % (përqindje) me NDP e parkimit me pagesë varion/kryhet rast pas rasti sipas ndërthurjes së treguesve të kategorizimit të rrjetit rrugor dhe kërkesë/ofertës për çdo ZAP.
5. NDP me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
 - a. vendparkim me pagesë;
 - b. vendparkim i rezervuar.
6. Kriteret për përcaktimin e NDP me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
 - a. rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi me pagesë kur vlerësimi sipas kritereve të NDP-së - që lidhen me kategorizimet e rrjetit rrugor dhe kategorizimet e Kërkesë/Ofertës krijon ndërthurje të Kategorisë 1.1 të Rrjetit Rrugor dhe Kategorisë 1.1 të Kërkesë/Ofertës - mundëson një rezervim nga 50% deri 100% të NDP-së në favor të parkimit me pagesë;
 - b. rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi të rezervuar me pagesë dhe/ose taksi bëhet në një masë jo më të madhe se 15% e NDP-së;
 - c. vlerësimi i NDP-ve me pagesë në raport % (përqindje) me NDP-të e parkimit pa pagesë varion rast pas rasti sipas ndërthurjes së treguesve të kategorizimit të rrjetit rrugor dhe kërkesë/ofertës për çdo NDP;
 - d. ditët e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi tokë) janë nga e hëna në të premten.

- e. për rrugët dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi tokë) që vlerësohen nga Drejtoria përkatëse në Bashki se gjatë fundjavave kanë aktivitet intensiv social dhe ekonomik, sistemi i kontrollit do të operojë nga e **hëna në të dielë** (sidomos në rrugët me aktivitet tregëtar, të njohura si rrugët/zonat tregtare).
 - f. parkimi me pagesë në zonat e miratuara si të tilla do të shtrijnë kohëzgjatjen prej orës **07.30 am deri në orën 20.00 pm;**
 - g. në të gjitha zonat çdo kategori parkimi në rrugë pas orës **20.00 p.m deri në 07.30 a.m** është parkim i lirë, i pa rezervuar dhe pa pagesë;
 - h. në raste specifike ku ofrohen shërbime të ndryshme private ose publike përgjatë orëve të natës në zonat e parkimit të përqëndruar jashtë rruge mbi tokë, parkimi me pagesë do të shtrijë kohëzgjatjen në një periudhë **24 orëshe;**
 - i. në zona të caktuara të shërbimit të parkimit me pagesë, vendoset kufizimi i kohëzgjatjes së qëndrimit nga jo më shumë se 2 orë deri në jo më shumë se 4 (katër) orë në të njëtin vend me pagesë. Vendimi përkatës merret nga Kryetari i Bashkisë nëse një rrugë ka kërkesë të lartë për parkim, për shkak të vendndodhjes afér:
 - a. zonave tregtare/tregjeve;
- zonave ku ofrohen shërbime të ndryshme publike dhe private

ANEKSI 2

7. Zonat e Administrimit të Parkimit (ZAP) në Qytetin e Tiranës (Harta Nr.1)



Zona 1.

Me kufij: vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Perëndimore, bulevardin "ZOG 1" në anën Lindore dhe kordonin hyrës me rrugët "Lazi Miho", "Konferanca e Pezës" duke vazhduar përgjatë buleardit "Gjergj Fishta" në anën jugore, deri në ndërprerjen me bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

Zona 2.

Me kufij: zonën përgjatë buleardit "ZOG 1" në pjesën perëndimore, vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Lindore dhe zgjatimin e buleardit "Zhanë D'Ark" deri në vijen kufizuese në anën Jugore.


Zona 3.

Me kufij: segmentin e buleardit "Dëshmorët e Kombit" në anën perëndimore, bulevardi "Bajram Curri" dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijen kufizuese në anën veriore dhe vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Jug/Lindore.

Zona 4.

Me kufij: kordonin hyrës përgjatë rrugës "Konferanca e Pezës" në anën veriore, bulevardin si vijë kufizuese e qytetit të Tiranës në anën lindore, zonën përgjatë segmentit të buleardit "Dëshmorët e Kombit" në pjesën Lindore dhe vijen kufizuese të Tiranës në pjesën jugore të saj.


8. Nënzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administrimit të parkimit nr. 1 (ZAP – 1) Harta nr. 2



Pasqyra e ZAP Nr.1

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE		PARKIM PA PAGESE (INVALIDE +I LIRE)
	%	%	
1 ÇAMERIA	60		40
2 ASIM VOKSHI	80		20
3 BLV. GJERGJ FISHTA(BLV. DËSHMORËT E KOMBIT-MUHAMET GJOLLESHA)	70		30
4 BLV. ZOGU 1 (KRAHU PERENDIMOR)	80		20
5 IBRAHIM RUGOVA (seg. MYSLYM SHYRI-BLV. GJERGJ FISHTA)	80		20
6 DEDË GJO LULI	83		17
7 E KAVAJËS	70		30
8 FORTUZI	40		60
9 FREDERIK SHIROKA	60		40
10 KONT URANI	40		60
11 MUHAMET GJOLLESHA	60		40
12 MUHEDIN LLAGANI	40		60
13 MYSLYM SHYRI	60		40
14 PANDI DARDHA	60		40
15 SAMI FRASHËRI	90		10
16 TEODOR KEKO	50		50
17 ASTRIT BALLUKU	40		60
18 NIKOLLA JORGA	60		40
19 BLV. DËSHMORËT E KOMBIT (seg. MYSLYM SHYRI-BLV. ZHANË D'ARK)	90		10

9. Nënzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administrimit të parkimit nr. 2 (ZAP – 2) Harta nr. 2



Pasqyra e ZAP Nr.2

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE	PARKIM PA PAGESE (INVALIDE + I LIRE)	
		%	%
1 KATËR DËSHMORET	40	60	
2 5 MAJ	60	40	
3 ALEKSANDËR MOISIU	60	40	
5 BLV. ZHANË D'ARK (seg. ARKITEKT KASEMI-ODHISE GRILLO)	70	30	
6 FERIT XHAJKO	90	10	
7 HOXHA TAHSIN	60	40	
8 LUIGJ GURAKUQI	80	20	
9 MYSLYM KETA	20	80	
10 ODHISE PASKALI	50	50	
11 QEMAL STAFJA	40	60	
12 RESHIT PETRELA	95	5	
13 BARDHYL	60	40	
14 E BARRIKADAVE	70	30	
16 E DIBRËS (SEGMENTI SIRI KODRA-5 MAJ)	50	50	
17 E DIBRËS (SEGMENTI BARDHYL-MYSLYM KETA)	95	5	
18 TAFAJ	60	40	
19 SIRI KODRA (E DIBRËS-FERIT XHAJKO)	60	40	
20 SIRI KODRA (FERIT XHAJKO-PRENG DOÇI)	30	70	
21 TEFTA TASHKO KOÇO	40	60	


10. Nënzonat e destuguara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administrimit të parkimit nr. 3 (ZAP – 3) Harta nr. 4



Pasqyra e ZAP Nr.3

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE		PARKIM PA PAGESE (INVALIDE +I LIRE)
	%	%	
1 PAPA GJON PALI II	70	30	
2 JUL VARIBOBA	60	40	
3 MUSTAFA MATCHITI	60	40	
4 PETRO NINI LUARASI	50	50	
5 THEMISTOKLI GËRMENJI	60	40	
6 BLV. BAJRAM CURRI (SEGMENTI PETRO NINI LUARASI-KONTI LEOPOLD BERTOLD)	50	50	
7 BLV. BAJRAM CURRI (SEGMENTI KONTI LEOPOLD BERTOLD-TEODOR MUZAKA)	70	30	
8 ISMAIL QEMALI	70	30	

11. Nënzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administritimit të parkimit nr. 4 (ZAP – 4) Harta nr. 5



Pasqyra e ZAP Nr.4

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE	PARKIM PA PAGESE (INVALIDE +I LIRE)	
		%	%
1 ALI KELMENDI	90	10	
2 BLV. BAJRAM CURRI	70	30	
3 BLV. BAJRAM CURRI	50	50	
4 Brigada VIII	90	10	
5 IBRAHIM RUGOVA	80	20	
6 JANOS HUNIADI	60	40	
7 EMIN DURAKU	70	30	
8 GJIN BUA SHPATA	60	40	
9 HAMDI PEPO	80	20	
10 KOMUNA E PARISIT	80	20	
11 LIMAN KABA	50	50	
12 LLAMBI BONATA	50	50	
13 NIKOLLA TUPE	70	30	
14 PASHKO VASA	50	50	
15 PERLAT REXHEPI	50	50	
16 PETRAQ LEKA	30	70	
17 PJETËR BOGDANI	80	20	
18 PJETËR BOGDANI	50	50	
19 PROKOP MIMA	30	70	
20 SAMI FRASHËRI	75	25	
21 DËSHMORËT E 4 SHKURTIT	60	40	
22 SKËNDER LUARASI	60	40	
23 SULEJMAN DELVINA	50	50	

12. Nënzonat e destiguara për parkim në sheshe (NDPSH) në zonat e administrimit të parkimit (ZAP) në qytetin e Tiranës Harta nr. 6



13. Të gjitha zonat e tjera të parkimit në rrugë që nuk përfshihen brenda zonave të shërbimit të parkimit (NDP) në hartat treguese, ose/dhe nuk janë pjesë e hartave/emërtesave të rrugëve të përfshira në pasqyrat e ZAP-ve, janë në këtë fazë parkim i lirë, parkim për rezidentë dhe pa pagesë.
14. Drejtoria respektive në Bashki kur vlerëson se janë plotësuar kushtet për shtrirjen e sistemit të parkimit, propozon për miratim pranë Kryetarit plotesimin, përmirësimin ose shtimin e NDP me nënzonat respektive në mbështetje të kritereve të përcaktuara në kapitujt përkatës. Gjithashtu e njëjta procedurë ndiqet në rastin kur NDP me nënzonat respektive bien ndesh me projektet për zbatim të korsive të dedikuara të transportit publik dhe bicikletave, duke bërë rishikimin e NDP ose nënzonave sipas rastit.
15. Bashkia e Tiranës të marrë masat për pajisjen e rezidentëve me autorizimet përkatëse për evidentimin e tyre në zonën e administrimit të parkimit (ZAP) ku banojnë.

ANEKSI NR. 3

Zonat Tarifore dhe Tarifat e Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës

1. Ndarja në Zona Tarifore sipas tipologjive

Zonat Tarifore - me qëllim vendosjen dhe vjetjen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre ndahen si më poshtë:

Zona A: Përfshin zonat më të nxehta ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet të lartë. Një pjesë të rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e Administrës Publike (qëndrore dhe lokale), qendrat e biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, lokalet dhe njësitë e shërbimit etj.

Zona B: Përfshin zonat ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet mesatar, ku qëndrimi i automjeteve në parkim zgjat normalisht 1-3 orë. Në këto zona kohëzgjatja e qëndrimit diktohet nga nevojat e klientëve, në bazë të standartit të jetesës së tyre dhe funksioneve të zonës.

Zona C: Përfshin zonat në zhvillim ku rrjeti rrugor kryesor nuk është shumë i dendur/intensiv. Rrugët sekondare për parkim shfrytëzohen kryesisht nga banorët/rezidentët e zonës dhe në mënyrë marzhinale nga vizitorët. Për këtë arsyе niveli i nevojave për vendparkim është krahasimisht më i vogël.

2. Tarifa e Shërbimit të Parkimit

2.1 Tarifa bazë e shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës përcaktohet si më poshtë vijon:

(i) Zona A

a. Tarifa për vendparkim në rrugë

100 Lekë /ora

b. Tarifa për vendparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 Minuta Falas	
0-3 orë	200
3- 8 orë	500
8- 12 orë	800
12 - 24 orë	500

Autobuzat	
1 orë	500
1 - 3 orë	1,000

3- 8 orë	2,000
8-24 orë	3,500

Mungesa e biletës sanksionohet me 3 000 Lekë gjobë.
Për Autobuzat raporti 1 me 3

c. Tarifat përvendosur për rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1 - Tarifat përvendosur për rezervuar në rrugë (kontrata 1 vjeçare)

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	Ditë /Vit	Total Orë	Tarifa/Lekë
Kontrata 1 vit (nga e hëna -të premte)	12	264	3,168	221,760
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	24	365	8,760	438,000
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	12	365	4,380	306,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të premte)	10	264	2,640	198,000
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	10	365	3,650	255,500

Tabela 2 - Tarifat përvendosur për rezervuar në sheshe

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	22 Ditë /Muaj	Total Orë	Tarifa / Lekë
Paketa 1 mujore	8	22	176	12,300
Paketa 3 mujore	8	66	528	35,000
Paketa 6 mujore	8	132	1056	67,500
Paketa 12 mujore	8	264	2112	132,000

(ii) Zona B

a. Tarifa përvendosur për rezervuar në rrugë

40 Lekë/ora

b. Tarifa përvendosur për rezervuar në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 Minuta falas	
0-3 Orë	100
3- 8 Orë	250
8- 24 Orë	300

Autobuzat	
1 Orë	250
1- 3 Orë	500
3- 8 Orë	800

8-24 Orë

1,000

Mungesa e biletës sanksionohet me 1,000 Lekë gjobë.
Për Autobuzat raporti 1 me 3.

c. Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1 - Tarifat për vendparkim të rezervuar rrugë

Paketa/Abonim	Orë/Ditë	Ditë /Vit	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3,168	88,704
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8,760	175,200
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4,380	122,640
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2,640	79,200
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3,650	102,200

Tabela 2 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa /Abonim	Orë/Ditë	22 Ditë/Muaj	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Paketa 1 mujore	8	22	176	5,000
Paketa 3 mujore	8	66	528	14,000
Paketa 6 mujore	8	132	1056	27,500
Paketa 12 mujore	8	264	2112	53,000

(iii)Zona C

a. Tarifa për vendparkim në rrugë

20 Lekë /Ora

b. Tarifa për vedparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 MIN free	
0 -3 Orë	50
3 - 8 Orë	120
8 - 24 Orë	250

Autobuzat	
1 Orë	150
1 - 3 Orë	300
3 - 8 Orë	300
8 - 24 Orë	500

Mungesa e biletës sanksionohet me 500 Lekë gjobë.

Për Autobuzat raporti 1 me 3

c. Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë

Paketa/Abonim	OIrë/Ditë	Ditë /Vit	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3,168	44,352
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8,760	87,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4,380	61,320
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2,640	39,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3,650	51,100

Tabela 2 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa /Abonim	Orë/Ditë	22 Ditë /Muaj	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Paketa 1 mujore	8	22	176	2,500
Paketa 3 mujore	8	66	528	6,600
Paketa 6 mujore	8	132	1056	13,000
Paketa 12 mujore	8	264	2112	25,000

2.2 Në varësi të zhvillimit social-ekonomik të njësisive administrative të Bashkisë së Tiranës Kryetari i Bashkisë së Tiranës nëpërmjet një urdhërese mund të caktojë nivele të ndryshme të tarifave të shërbimit të parkimit në kufijtë minus 30% / plus 30 % të tarifës bazë.

2.3 Në varësi të ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës në treg Kryetari i Bashkisë Tiranës nëpërmjet një urdhërese mund të caktojë nivele të ndryshme të tarifave të shërbimeve të parkimit në kufijtë minus 30% / plus 30 % të tarifës bazë.

2.4 Të ngarkojë Parking Tirana për vjeljen e tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës.

3. Zonat Tarifore në Qytetin e Tiranës

Ndarja në zona sipas karakteristikave të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aneksi, me qëllim vendosjen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë në qytetin e Tiranës është si më poshtë vijon:



BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. 16670

Tiranë 03/11 /2015

Drejtuar: **z. Aldrin Dalipi**
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Inderuar z. Dalipi,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim e miratim relacionin dhe projekt-vendimin për “Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimi dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruar nga Bashkia e Tiranës”

Me respekt

K R Y E T A R I

Erion Veliaj




BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK

Vendim (Projekt)

Nr. _____ datë _____ 2015

PËR

“Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit, nënzonave të destinuara për parkim në qytetin e Tiranës dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruara nga Bashkia e Tiranës”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I, shkronja “b”, nenit 8, pika 1/III, shkronja “b”, nenit 16 pika 3 shkronja “a”, nenit 32, shkronja “f” dhe nenit 33, pika 3 , të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 121 pika 1, 124 pika 1 dhe nenit 125 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); nenit 35 pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.28, datë 19.06.2006 “Për miratimin e projektit për një sistem të ri parkimi për Tiranën”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit në Bashkinë e Tiranës dhe nënzonave të destinuara për parkim sipas Aneksit 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë zonat e administrimit të parkimit në qytetin e Tiranes dhe respektivisht nënzonat e destinuar për parkim sipas Aneksit 2 bashkëlidhur, për të vendosur Tirana Parking në kushte pune.
3. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të vlerësojë plotësimin e kushteve për shtrirjen e zonave të administrimit të parkimit (“ZAP”) në Bashkinë Tiranë dhe respektivisht të ndjekë procedurat për plotësimin, përmirësimin ose shtimin nënzonave të destinuara për parkim (“NDP”) duke u bazuar në kritereve të përcaktuara në Aneksi 1.
4. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të rishikojë dhe përcaktojë një ndarje të re të zonave të administrimit të parkimit (“ZAP”) dhe respektivisht nënzonave të destinuara për parkim (“NDP”) nëse nuk përputhen me projektejt për zbatim të korsive të dedikuara transportit publik dhe bicikletave.
5. Të përcaktojë tarifat e shërbimit të parkimin të administruara nga Bashkia e Tiranës sipas Aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Pika 1/1.2, shkronja”c”, “*Tarifën e Parkimit të Automjeteve*” e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 05.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” shfuqizohet.
7. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.01.2006 “Për përcaktimin e vendndodhjes së parkimeve me pagesë për shërbimin taksi (4+1, (8+1) dhe të mjeteve për transport të mallrave për të tretë në qytetin e Tiranës” dhe vendimi i Këshillit Bashkiak nr.3, date 03.02.2003, “ Mbi caktimin e vendparkimeve publike me pagesë ne qytetin e Tiranes” (i ndryshuar) shfuqizohen.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë dhe Tirana Parking.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Aldrin Dalipi



BASHKIA E TIRANËS

RELACION

PËR

“Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit, nënzonave të destinuara për parkim në qyetin e Tiranës dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I, shkronja “b”, nenit 8, pika 1/III, shkronja “b”, nenit 16 pika 3 shkronja “a”, nenit 32, shkronja “f”, nenit 33, pika 3 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 dhe nenit 37 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 121 pika 1, 124 pika 1 dhe nenit 125 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar”); nenit 35 pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar) ; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 19.06.2006 “Për miratimin e projektit për një sistem të ri parkimi për Tiranën”; me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit dhe Planifikimit të Shërbimeve, i propozohet Këshilli Bashkiak:

Hyrje

Ndarja e re territoriale e përball stafin e ri të Bashkisë me nevojën e një ndryshimi të plotë ristrukturues në mënyrën e administrimit dhe menaxhimit të gjithë shërbimeve të transportit.

Në kontekstin e ri urban me (i) një diversitet të lartë, (ii) rritje të numrit të popullsisë, (iii) rritje të numrit të automjeteve për banorë, (iv) kërkesa jo homogjene për lëvizje sipas zonave të ndryshme të qytetit, (v) nevojat për infrastrukturë funksionale që kanë grupe të popullsisë me densitet jo të madh por të shtrirë në territor, kërkohet një përqasje e mirëmenduar e në ofrimin e alternativave të lëvizshmërisë, parashikimin e ndërhyrjeve në kategoritë e trasportit dhe mënyrës se si duhet menaxhuar trafiku.

Bashkia e Tiranës po i kushton një vëmendje të veçantë transportit dhe lëvizjes në qytetin e Tiranës, si një nga prioritetet më të rëndësishme të punës tonë, sipas kërkesave dhe nevojave të qytetarëve dhe qytetit.

Nga analiza e bërë për çështjet e transportit, në zërthim të koncepteve të lëvizjes multimodale që parashikohen në studimet ekzistuese¹ për pjesën e ish qytetit tradicional të

¹ Masterplani transportit ose “Strategjia e Transportit te Qendrueshem” 2009, financuar nga Banka Europeiane per Rindertim dhe Zhvillim (EBRD) , si dhe studimi Plani Urban Tematik i Tiranes finansuar nga Qeveria Japoneze nepermjet agjancise JICA ne 2011.

Bashkisë së re të Tiranës, kemi filluar punën më elementë të veçantë të transportit dhe lëvizjes, ndër të cilat, një çështje/fushë e rëndësishmë është organizimi dhe administrimi i parkimit në qytetin e Tiranës.

Me qëllim administrimin e parkimit duhet të vendosen kriteret për përcaktimin e vendeve të destinuara për parkimin dhe të krijohen zonat e parkimit të kontrolluar (me ose pa pagesë) si për parkimin në rrugë, po ashtu edhe për parkimin jashtë rruge (që sot është i lirë).

Pasi është bërë analiza e situatës, vlerësimi i nevojave dhe mundësítë për organizmin e parkimit, propozohen shqyrtimi dhe miratimi i:

- a. kritereve për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit ("ZAP"); dhe
- b. kritereve për detajimin e ZAP dhe përcaktimin e nënzonave të destinuara për parkim (NDP); si dhe
- c. tarifat që do të aplikohen kundrejt ofrimit të shërbimit të parkimit publik me pagesë.

Më konkretisht:

Parkimi, si në rrugë ashtu edhe jashtë-rruge (mbi dhe nën-tokë), është një aspekt i rëndësishëm dhe shumë kritik për një qytet, veçanërisht për një qytet qendër të aktiviteteve sociale dhe ekonomike si Tirana.

Zhvillimet demografike dhe ato soci-ekonomike të qendrës më të madhe urbane dhe administrative të vendit-Tiranës- kanë nxjerr në pah nevojën për organizmin e parkimit dhe lehtësimin e lëvizjes sipas parimeve të mobilitetit (multimodal).

Parkimi në një qytet u lejon klientëve të vizitojnë biznese dhe pjesë të tjera të qytetit, rezidentëve të qytetit të marrin mjete në pronësi dhe të planifikojnë shpërndarjen e tyre në aktivitetet sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, parkimi është i nevojshëm në një qytet për të inkurajuar trafikun dhe kënaqur rezidentët e tij me aktivitete tregëtare, sociale etj.

Megjithatë, parkimi është një çështje e komplekse, e cila ka një impakt të drejtpërdrejtë mbi transportin urban dhe atë rajonal, mobilitetin, aksesin, zhvillimin, cilësinë e mjedisit dhe përdorimin e hapësirës urbane.

Politikat e parkimit, të lidhura me Masterplanin e Transportit në qytetin e Tiranës, mund të inkurajojë komunitetin të dalë ose jo me makinë në qytet, të rëndohet ose jo situata e rrugëve dhe të shtohet ose jo ndotja e ambientit. Kjo politikë drejtohet në krijimin e zonave të administruara të parkimit ose zonave të shërbimit, në të cilën do të aplikohen nivele të regullimeve të ndryshme mbi një mekanizëm kontrolli/administrimi të përcaktuar. Vendosja nën kontroll/administrim do të përcaktohet sipas kritereve, rregullave, kufizimeve dhe lejimeve për të krijuar përdorimin më të mirë të mundshëm të hapësirës/zonës së parkimit sipas përdoruesve, orareve, destinacionit dhe pozicionit, për të akomoduar edhe kërkosat e banimit, por edhe ato të aktiviteteve administrative dhe tregëtare, pra për të mbështetur zhvillimin ekonomik, por duke inkurajuar transportin multimodal dhe shbangur "konfliktet" me trafikun dhe lëvizjen.

Kriteret për përcaktimin e zonave të destinuara per parkimin shërbejnë si një instrument për të arritur zgjidhjet/kërkosat për sa më sipër.

Zonat e administrimit të parkimit dhe nënzonat e destinura për parkim

Zonat e administrimit të parkimit në territorin e Bashkisë së Tiranës ("ZAP") do të jenë zonat që përfshihen në sistemin e kontrolluar të administrimit të parkimit nga Bashkia e Tiranës. Për efekt organizimi dhe kontrolli të shërbimit të parkimi publik dhe, më gjerë, zbatimit të planeve të lëvizshmërisë, ZAP-të detajohen në nënzonat. Detajimi identifikon nënzonat e destinuara për parkimin - në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) ("NDP").

Kriteret e imëta për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonimi i tyre ilustrohen në Aneksin nr. 1. Zonimi dhe nënzonimi janë aktivite me karakter ngushtësisht teknik dhe ekzekutiv. Duke u nisur nga kjo specifikë propozohet t'i ngakohet Kryetarit të Bashkisë *analiza, identifikimi dhe përfshija e mëtejshme e ZAP-ve/NDP-ve në sistemin e administrimit të kontrolluar të parkimit në territorin e Bashkisë së Tiranës*. Kjo kushtëzuar nga / në varësi të plotësimit të kritereve të përcaktuara në Aneksin nr.1.

Zonat e administrimit të parkimit (ZAP) dhe nënzonat e destinuara për parkim (NDP) në qytetin e Tiranës

Për t'i ofruar Tirana Parking instrumentat e duhur të punës dhe për qëllimet e sipër përmendura që lidhen me rëndësinë e planifikimit të mirëmenduar të lëvizshmërisë/trasportit, u përcaktuan ZAP-të dhe disa nga NDP-të në qytetin e Tiranës.

Për këtë proces, u konsiderua e domosdoshme kryerja e një analize të mëtejshme, mbi të dhëna dhe matje reth:

Disponibilitetit të hapësirave rrugore për vendparkime në qytetin e Tiranës

Për hartimin e një skeme të qartë dhe të detajuar mbi "zonat e administrimit të parkimit" në qytetin e Tiranës, brenda të cilave ndodhen "zonat e parkimit" (parkimin e kontrolluar), pikë së pari u krijuat një sistem të dhënash mbi hapësirat e destinuara për parkimi, disponibiliteti i të cilave varet nga elementi infrastrukturor (kuadri i programit të rikonstrukcionit të infrastrukturës rrugor) dhe në përshtatje me ambientin ekzistues të zonave të banuara, duke pasur parasysh karakteristikat dhe mundësitë për parkim të rrugëve në qendër, por edhe në zona të brendshme periferike të qytetit etj. Analiza orientohet mbi kapacitetin/disponibilitetin për parkim në rrugë, për të vijuar më pas me atë jashtë rruge, si nivel rregullimi.


Për krijimin e një *data-base* dhe përpunimin e këtyre të dhënave, bazuar në projektet e qarkullimit rrugor me shënimet përkatëse (sinjalitika horizontale dhe vertikale) dhe Planeve të Transportit (Masterplanit, planeve të qarkullimit, projekteve të lëvizjes multi-modale) u përdor harta e rrjetit rrugor ekzistues në programin GIS.

Në sistemin bazë të të dhënave përfshihen (Fig I):

- emërtimi i rrugës
- gjatësia e aksit rrugor
- kategoria e rrugës (sipas përcaktimeve në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor")
- numri i vendparkimeve të mundura
- drejtimi lëvizjes
krahu i lejuar i parkimit

Duhet theksuar se, ky identifikim u shtri dhe në rrugët e brendëshme lokale, me qëllim kontrollin e hapësirave të parkimit brenda tyre. Duke u përballur me pagesat në rrugët kryesore, shoferët e në veçanti ato që duan të parkojnë për një kohë të gjatë, do të zgjidhnin të parkonin falas në rrugët afër me banesën për të shmangur pagesën. Ndërkohë që këto zona janë zona të lira për rezidentët dhe të destinuara për ta.

Fig. I




Për llogaritjen e hapësirës që aktualisht është e disponueshme për parkimin (pra për të përcaktuar zonat e parkimit dhe rregullat/kriteret), u morën parasysh:

- a. hapësirat e nevojshme për kryqëzimet, duke konsideruar 5 m (minimalisht) nga fundi i parkimit deri në distancën e fillimit të korsisë dhe 30 m nga impiantet semaforike - këto hapësira janë të rëndësishme për gjithë trafikun dhe sigurinë e këmbësoreve rrugore;
- b. hapësirat e zëna nga koshat e mbeturinave në rrugë;
- c. hapësirat e zëna nga zonat e ndalimit për shërbimet e transportit publik (stacionet e autobuzave) etj.

Ndarja e zonave të administrimit të parkimit në qytetin e Tiranës

Në përputhje me kushtet vendore u krijuan katër zona të administrimit të parkimin 1, 2, 3, 4, brenda të cilave të gjitha rrugët do të kontrollohen dhe rregullohen për efekt të organizimit të parkimit. Si kufi natyror i tyre u përdorën lumi i Lanës dhe korridori veri-jug/Zogu i Parë dhe Bulevardi "Dëshmorët e Kombit".

Harta e ndarjes të zonave të shërbimit të parkimeve që do të kontrollohen jepet si më poshtë:



Theksojmë se administrimi i shërbimi i parkimit do të organizohet në këto zona. Kontrolli i këtyre zonave të parkimit (bazuar mbi studimet dhe mundësitë reale të komentuara më sipër), krijon zonat e shërbimit, në të cilat parashikohen:

(i) Parkimet pa pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge

- Numri i parkimeve të rezervuara për automjetet e personave me aftësi të kufizuar pa pagesë.
- Numri i parkimeve të lira (pa roja ose pa sisteme kontrolli dhe pa pagesë) (për rezidentët dhe në orë të lira etj.).

(ii) Parkimet me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge me pagesë:

- Numri (ose %) i vendparkimeve publike me pagesë, në rrugë, ku përfshihet dhe numri (ose %) e parkimeve të rezervuara publike me pagesë (institucion; subjekt i interesuar etj.) në rrugë.

Karakteristikat e zonave sipas kërkesë-ofertës

Zona A: Përfshin zonat më të nxeha ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet të lartë. Një pjesë të rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e Administrës Publike (qëndrore dhe lokale), qendrat e biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, lokalet dhe njësitë e shërbimit etj. Nga sondazhet e kryera, hapësirat e parkimit në rrugë shfrytëzohen maksimalisht, sidomos gjatë mesditës kur kërkesat janë më të mëdha se numri i vëndparkimeve disponibël.

Të gjitha mundësitë aktuale për parkime jashtë hapësirave të rrugëve brenda unazës së mesme shfrytëzohen për parkim, me përjashtim të zonave të rikonstruktuar, në të cilat është bërë i mundur ndërtimi i trotuareve dhe përcaktimi i vëndparkimeve në rrugë. Gjatë natës, rezidentët i parkojnë makinat e tyre në hapësirat jashtë rrugëve.

Është e rëndësishme dhe e domosdoshme që zonat jashtë rrugëve, brenda unazës së mesme, të analizohen që të krijohet menjëhere një hierarki e destinacioneve të tyre për të marrë në konsideratë zgjedhjet më oportune; në këtë radhë destinacionesh parkimi sigurisht do të jetë një nga mundësitet. Kjo është një fazë e dytë që do të konkretizohet me nënzonimin/detajimin e zonës së administrimit të parkimit.

Balanca midis kërkesës dhe ofertës për parkim është një nga çështjet kryesore që shtrohet dhe çon në zgjidhjen e disa problemeve p.sh. mungesa e kapaciteteve të parkimit (në dhe jashtë-rrugës) në hapësirat e bizneseve në qytet, mund të vonojë rritjen ekonomike të qytetit, mund të krijojë stres tek shoferët të cilët kërkojnë parkim dhe mund të rezultojë në rritje të trafikut. Ashtu si edhe nga ana tjetër, një ofertë e madhe parkimi, mund të rrisë numrin e makinave që hyjnë në qytet, duke reduktuar përdorimin e transportit publik, duke pasur impakt negativ në mjedis, në mëyrën e jetesës për qytetarët, ashtu dhe në rritjen e ngarkesës së rrugëve kryesore të qytetit. Prandaj, parkimi i kontolluar, si një instrument rregullator, krijon rregulla përdorimi që synon të balancoj kërkesat me mundësitë, por edhe të inkurajojë/dekurajojë sjelljë të caktuara të dretjuesve të mjeteve, në përputhje me politikat e lëvizjes në zona të caktuara në qytet.

Zona B: Përfshin zonat ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet mesatar, ku qëndrimi i automjeteve në parkim zgjat normalisht 1-3 orë. Në këto zona kohëzgjatja e qëndrimit diktohet nga nevojat e klienteve, në bazë të standartit i jetesës së tyre dhe funksioneve të zonës.

Zona C: Përfshin zonat në zhvillim ku rrjeti rrugor kryesor nuk është shumë i dendur/intensiv. Rrugët sekondare për parkim shfrytëzohet kryesisht nga banorët/rezidentët e zonës dhe në menyrë marzhinale nga vizitorët. Për këtë arsyе niveli i nevojave për vendparkim është krahasimisht më i vogël.

Ditët, orët vepruese dhe kohëzgjatja e qëndrimit

Një nga qëllimet e kontrollit/administrimit të parkimit në rrugë dhe zonat jashtë rruge është vendosja e një kufiri se, sa gjatë një drejtues mjeti mund të parkojë në një zonë të caktuar përkundrejt me drejtues të tjerë që duan të rinë më gjatë dhe që kërkon përdorimin e parkimeve jashtë atyre të përcaktuara në rrugë (parkimi *aftashkurtër* dhe *afatgjatë*, që përcaktohet nga kohëqëndrimi dhe rregullat e përcaktuara për kohëqendrimin e lejuar). Përcaktimi i kohës limit bëhet duke vendosur një raport të drejtë midis survejimit të parkimit (raporti ofertë/kërkesë) dhe parimit të "rrotullimit" në hapësirat e parkimit. Ky parim (i rrotullimit) bazohet në atë që se sa shoferë të tjerë kanë mundësinë të parkojnë në një zonë/hapësirë të caktuar parkimi gjatë kohëzgjatjes së parkimit të kontrolluar.

Ditët, në të cilat do të paguhet, përcaktohen në varësi të sjelljes së përdoruesve të rrugës. Deri më sot është operuar vetëm gjatë ditëve të punës (nga e hëna në të premtë). Sigurisht, kjo e kushtëzuar dhe me faktin që menaxhimi i shërbimit të parkimit bazohet tek sjellja dhe eksperiencia lokale. Për disa zona le të trajtojmë si pikë fillestare e parkimit të kontrolluar ku dhe gjatë fundjavave ka aktivitet të dendur social, sistemi i ri i kontrollit do të operojë nga e hëna në të dielë (sidomos në rrugët me aktivitet tregëtar, të njoitura si rrugët/zonat tregëtare).

Orët: siç e theksuan më lart, rrugët duhet të kontrollohen për të mbrojtur banorët nga parkimi i pa kontrolluar. Në funksion të kësaj, bazuar dhe në rekomandimet e ekspertëve të huaj, në mënyrë tipike pagesat për parkim duhet të aplikohen nga ora 7.30-20.00. Duhet theksuar se

dhe në periudhën në vazhdim duhet të monitorohet sjellja e parkimit dhe të ndërmeren rregullime, kur ato kërkohen. Për këtë, Bashkia duhet dhe do të hartojë Rregulloren e Parkimit sipas zonave dhe përdoruesve për qytetin e Tiranës.

Tarifat e shërbimit të parkimit

Në vijim të propozimit për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit publik të parkimit, propozojmë gjithashtu miratimin e tarifave të shërbimit (sikurse referuar në Aneksin nr. 3 të këtij projekt vendimi), si dhe zonat e administrimit dhe disa nënzonat e destinuara për parkimi në qytetin e Tiranës (sikurse referuar në Aneksin nr. 2 të këtij projekt vendimi). Miratimi i këtij propozimi do të vendoste institucionin e sapokrijuar në kushte pune.

Parashtrojmë, gjithashtu, se struktura e tarifave të propozuara është ndërtuar mbi këtë llogjike:

- tarifat do të aplikohen në të gjithë territorin Bashkisë së Tiranës. Kjo në varësi të identifikimit dhe përfshirjes së ZAP/NDP-ve në sistemin e administrimit të kontrolluar në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin nr.1;
- tarifat përcaktohen sipas zonave tarifore A, B dhe C dhe përkatesisht ndahen në: (a) tarifë/ore/vendparkim rrugë; (b) tarifë/orë/vendparkim zonë jashtë rruge dhe (c) tarifë për parkim të rezervuar rrugë/zonë jashtë rruge;
- duke konsideruar zhvillimin social-ekonomik të njësisë/ve administrative ku eventualisht do të shtrihet shërbimi dhe kërkesës/ofertës në treg, parashikohet mundësia të ndryshohen tarifat në kufijtë -/+ 30% të tarifës bazë.

Për sa më sipër, shpresojmë në miratimin e këtij propozimi nga ana juaj,

Besmira Petriti

Specialist i Sektorit të Asiştencës Ligjore dhe Legjislacionit

Artur Xhaka

Specialist i Sektorit të Sigurisë Rrugore

Kliton Jani

Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë Rrugore

Gentian Nechëatal

Përgjegjës i Sektorit të Rrjetit Rrugor

Jonida Halili


Drejtore i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik

Taulant Tusha

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve,

Itena Ndroqi

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse




Behar Zeneli

Sekretar i Këshillit Bashkiak



Arsela Gjonaj

Jurist i Këshillit Bashkiak



ANEKSI NR. 1

Kriteret për përcaktimin e Zonave të Administrimit të Parkimit dhe nënzonimi i tyre

1. Zonat e administrimit të parkimit në territorin e Bashkisë së Tiranës (“ZAP”) janë zonat që përfshihen në sistemin e kontrolluar të administrimit të parkimit nga Bashkia e Tiranës.
2. ZAP konsiderohen zonat që plotësojnë kriteret sipas:
 - a. **Përcaktimeve të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:** ku përfshihen të gjitha karakteristikat/normat teknike dhe funksionale që lidhen me përcaktimin e parkimit dhe ndërlidhjen e tij me elementët e rrugës ose jo.
 - b. **Masterplanit të Transportit:** ku përfshihen të gjitha elementët e planifikimit të transportit që krijojnë/mundësojnë realizimin e zonave/nënzonave të shërbimit të parkimit në ZAP.
 - c. **Planit të qarkullimit të mjeteve:** ku përfshihen të gjitha mundësitë që ofron plani i lëvizjes në raport me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.
 - d. **Kushteve të infrastrukturës rrugore:** ku përfshihen kushtet fizike të infrastrukturës rrugore, e rikonstruktuar ose e parikonstruktuar dhe lidhja e saj me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.
 - e. **Kategorizimeve të rrjeti rrugor dhe zonat jashtë rruge sipas shkallës/intensitetit të aktivitetit social ekonomik:**
 - (i) Kategoria e 1 – Rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) që vlerësohen me aktivitet të dendur/intensiv social dhe ekonomik sidomos në rrugët me aktivitet tregëtar, të njohura si rrugët/zonat tregëtare sipas të dhënavë të grumbulluara nga arshiva e informacionit (GIS);
 - (ii) Kategoria e 2 – Rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) që vlerësohen jo me aktivitet të dendur social dhe ekonomik dhe jo me aktivitet të dendur tregëtar, por që kanë një intesitet mesatar të fushave të mësipërme sipas të dhënavë të grumbulluara nga arshiva e informacionit (GIS);
 - (iii) Kategoria e 3 – Rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) që vlerësohen pa aktivitet social dhe ekonomik dhe me aktivitet të vogël/osc fare tregëtar sipas të dhënavë të grumbulluara nga arshiva e informacionit (GIS).
 - f. **Kriteri i kërkesë/ofertës:** Disponibilitetin e hapësirave rrugore dhe zonave jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) për vëndparkime vs. ofertës dhe kërkesës për parkim, sipas shkallës së zënies ku:
 - (i) Kategoria 1.1
 - a. Shkalla e zënies > 100% në momentet e pikut.
 - b. Shkalla e zënies > 100% në momentet e jopikut.
 - (ii) Kategoria 1.2

- a. Shkalla e zënies > 100% në momentet e pikut.
- b. Shkalla e zënies 80% deri në 100% në momentet e jopikut.

(iii) Kategoria 1.3


- a. Shkalla e zënies < 100% në momentet e pikut.
- b. Shkalla e zënies < 100% në momentet e jopikut.

3. ZAP-të detajohet në nënzonat. Detajimi identifikon nënzonat e destiguara për parkimin - në rrugë dhe/ose dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) - në zonat ZAP ("NDP").
4. NDP-të pa pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve përfshijnë:
 - a. parkim për rezidentët;
 - b. parkim i lirë pa roje ose pa sisteme kontrolli të kohëzgjatjes së qëndrimit (pa pagesë);
 - c. parkim i rezervuar për automjetet e personave me aftësi të kufizuar pa pagesë.
5. Kriteret për përcaktimin e NDP pa pagesë në rrugë dhe zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
 - a. rezervimit i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e personave me aftësi të kufizuar (PAK) dhe parkimit të lirë pa roja ose pa sisteme (PL) në një masë jo më e vogël se 5% e NDP
 - b. rezervimit i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e banorëve (AB). ka si kriter vlerësimi kriteret që lidhen me kategorizimin e rrjetit rrugor dhe kërkesë ofertës ku ndërthurja e Kategorisë 3 të Rrjetit Rrugor dhe Kategorisë 1.3 të Kërkesë/Ofertës mundëson një rezervim:
 - (i) deri 70% të NDP në favor të (AB),
 - (ii) deri 30 % të NDP në favor të (PL) dhe (PAK).
6. Vlerësimi i NDP pa pagesë në raport % (përqindje) me NDP e parkimit me pagesë varion/kryhet rast pas rasti sipas ndërthurjes së treguesve të kategorizimit të rrjetit rrugor dhe kërkesë/ofertës për \square do ZAP.
7. NDP me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
 - a. vendparkim me pagesë;
 - b. vendparkim i rezervuar.
8. Kriteret për përcaktimin e NDP me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi dhe nëntokë) brenda ZAP-ve janë:
 - a. rezervimit i një numri të caktuar vendesh parkimi me pagesë kur vlerësimi sipas kriterive të NDP-së - që lidhen me kategorizimet e rrjetit rrugor dhe kategorizimet e Kërkesë/Ofertës krijon ndërthurje të Kategorisë 1.1 të Rrjetit Rrugor dhe Kategorisë 1.1 të Kërkesë/Ofertës - mundëson një rezervim nga 50% deri 100% të NDP-së në favor të parkimit me pagesë;
 - b. rezervimit i një numri të caktuar vendesh parkimi të rezervuar me pagesë dhe/ose taksi bëhet në një masë jo më të madhe se 15% e NDP-së;

- c. vlerësimi i NDP-ve me pagesë në raport % (përqindje) me NDP-të e parkimit pa pagesë varion rast pas rasti sipas ndërthurjes së të treguesve të kategorizimit të rrjetit rrugor dhe kërkesë/ofertës për do NDP;
- d. ditët e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi tokë)janë nga **e hëna në të premten.**
- e. për rrugët dhe/ose zonat jashtë rruge (mbi tokë) që vlerësohen nga Drejtoria përkatëse në Bashki se gjatë fundjavave kanë aktivitet të intensiv social dhe ekonomik, sistemi i kontrollit do të operojë nga **e hëna në të dielë**. (sidomos në rrugët me aktivitet tregëtar, të njoitura si rrugët/zonat tregëtare).
- f. parkimi me pagesë në zonat e miratuara si të tilla do të shtrijnë kohëzgjatjen prej orës **07.30 am deri në orën 20.00 pm**;
- g. në të gjitha zonat çdo kategori parkimi në rrugë pas orës **20.00 p.m deri në 07.30 a.m** është parkim i lirë, i pa rezervuar dhe pa pagesë;
- h. në raste specifike ku ofrohen shërbime të ndryshme private ose publike përgjatë orëve të natës në zonat e parkimit të përqëndruar jashtë rruge mbi tokë, parkimi me pagesë do të shtrijë kohëzgjatjen në një periudhë **24 orëshe**;
- i. në zona të caktuara të shërbimit të parkimit me pagesë, vendoset kufizimi i kohëzgjatjes së qëndrimit nga jo më shumë se 2 orë deri në jo më shumë se 4 (katër) orë në të njëjtin vend me pagesë. Vendimi përkatës merret nga Kryetari i Bashkisë nëse një rrugë ka kërkesë të lartë për parkim, për shkak të vendëndodhjes afér:
 - a. zonave tregëtare/tregjeve;
 - b. zonave ku ofrohen shërbime të ndryshme publike dhe privat.

ANEKSI 2

1. Zonat e Administrimit të Parkimit (ZAP) në Qytetin e Tiranë (Harta Nr.1)



Zona 1.

Me kufij: Vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Perëndimore, bulevardin "ZOG 1" në anën Lindore dhe kordonin hyrës me rrugët "Lazi Miho", "Konferanca e Pezës" duke vazhduar përgjatë buleardit "Gjergj Fishta" në anën jugore, deri në ndërprerjen me bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

Zona 2.

Me kufij zonën përgjatë buleardit "ZOG 1" në pjesën perëndimore, vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Lindore dhe zgjatimin e buleardit "Zhanë D'Ark" deri në vijen kufizuese në anën Jugore.

Zona 3.


Me kufij segmentin e buleardin "Dëshmorët e Kombit" në anën perëndimore, bulevardi "Bajram Curri" dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijen kufizuese në anën veriore dhe vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Jug/Lindore.

Zona 4.

Me kufij kordonin hyrës përgjatë rrugës "Konferanca e Pezës" në anën veriore, bulevardin vijen kufizuese të qytetit të Tiranës në anën lindore, zonën përgjatë segmentit

të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” në pjesën Lindore dhe vijën kufizuese të Tiranës në pjesën jugore të saj.


- Nëzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administrimit të parkimit nr. 1 (ZAP – 1) Harta nr. 2



Pasqyra e ZAP Nr.1

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE	PARKIM PA PAGESE (INVALIDE + LIRE)	
		%	%
1 ÇAMERIA	60	40	
2 ASIM VOKSHI	80	20	
3 BLV. GJERGJ FISHTA(BLV. DËSHMORËT E KOMBIT-MUHAMET GJOLLESHA)	70	30	
4 BLV. ZOGU 1 (KRAHU PERENDIMOR)	80	20	
5 IBRAHIM RUGOVA (seg. MYSLYM SHYRI-BLV. GJERGJ FISHTA)	80	20	
6 DEDË GJO LULI	83	17	
7 E KAVAJËS	70	30	
8 FORTUZI	40	60	
9 FREDERIK SHIROKA	60	40	
10 KONT URANI	40	60	
11 MUHAMET GJOLLESHA	60	40	
12 MUHEDIN LLAGANI	40	60	
13 MYSLYM SHYRI	60	40	
14 PANDI DARDHA	60	40	
15 SAMI FRASHËRI	90	10	
16 TEODOR KEKO	50	50	
17 ASTRIT BALLUKU	40	60	
18 NIKOLLA JORGA	60	40	
19 BLV. DËSHMORËT E KOMBIT (seg. MYSLYM SHYRI-BLV. ZHANË DARK)	90	10	


3. Nënzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administritimit të parkimit nr. 2 (ZAP – 2) Harta nr. 2



Pasqyra e ZAP Nr.2

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE		PARKIM PA PAGESE (INVALIDE +I LIRE)
	%	%	
1 KATËR DËSHMORËT	40	60	
2 5 MAJ	60	40	
3 ALEKSANDËR MOISIU	60	40	
5 BLV. ZHANË D'ARK (seg. ARKITEKT KASEMI-ODHISE GRILLO)	70	30	
6 FERIT XHAJKO	90	10	
7 HOXHA TAHSIN	60	40	
8 LUIGJ GURAKUQI	80	20	
9 MYSLYM KETA	20	80	
10 ODHISE PASKALI	50	50	
11 QEMAL STAFJA	40	60	
12 RESHIT PETRELA	95	5	
13 BARDHYL	60	40	
14 E BARRIKADAVE	70	30	
16 E DIBRËS (SEGMENTI SIRI KODRA-5 MAJ)	50	50	
17 E DIBRËS (SEGMENTI BARDHYL-MYSLYM KETA)	95	5	
18 TAFAJ	60	40	
19 SIRI KODRA (E DIBRËS-FERIT XHAJKO)	60	40	
20 SIRI KODRA (FERIT XHAJKO-PRENG DOÇI)	30	70	
21 TEFTA TASHKO KOÇO	40	60	


4. Nënzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administritimit të parkimit nr. 3 (ZAP – 3) Harta nr. 4



Pasqyra e ZAP Nr.3

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE		PARKIM PA PAGESE (INVALIDE +I LIRE)
	%	%	
1 PAPA GJON PALI II	70	30	
2 JUL VARIBOBA	60	40	
3 MUSTAFA MATOHITI	60	40	
4 PETRO NINI LUARASI	50	50	
5 THEMISTOKLI GĒRMENJI	60	40	
6 BLV. BAJRAM CURRI (SEGMENTI PETRO NINI LUARASI-KONTI LEOPOLD BERTOLD)	50	50	
7 BLV. BAJRAM CURRI (SEGMENTI KONTI LEOPOLD BERTOLD-TEODOR MUZAKA)	70	30	
8 ISMAIL QEMALI	70	30	


5. Nënzonat e destinuara për parkim në rrugë (NDPRr) në zonën e administritimit të parkimit nr. 4 (ZAP – 4) Harta nr. 5



Pasqyra e ZAP Nr.4

EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME PAGESE		PARKIM PA PAGESE (INVALIDE + I LIRE)
	%	%	
1 ALI KELMENDI	90		10
2 BLV. BAJRAM CURRI	70		30
3 BLV. BAJRAM CURRI	50		50
4 Brigada VIII	90		10
5 IBRAHIM RUGOVA	80		20
6 JANOS HUNIADI	60		40
7 EMIN DURAKU	70		30
8 GJIN BUA SHPATA	60		40
9 HAMDI PEPO	80		20
10 KOMUNA E PARISIT	80		20
11 LIMAN KABA	50		50
12 LLAMBI BONATA	50		50
13 NIKOLLA TUPE	70		30
14 PASHKO VASA	50		50
15 PERLAT REXHEPI	50		50
16 PETRAQ LEKA	30		70
17 PJETËR BOGDANI	80		20
18 PJETËR BOGDANI	50		50
19 PROKOP MIMA	30		70
20 SAMI FRASHËRI	75		25
21 DËSHMORËT E 4 SHKURTIT	60		40
22 SKËNDER LUARASI	60		40
23 SULEJMAN DELVINA	50		50

- Nënzonat e destinuara për parkim në sheshe (NDPSH) në zonat e administritimit të parkimit (ZAP) në qytetin e Tiranës Harta nr. 6



- Të gjitha zonat e tjera të parkimit në rrugë që nuk përfshihen brenda zonave të shërbimit të parkimit (NDP) në hartat treguese, ose/dhe nuk janë pjesë e hartave/emërtesave të rrugëve të përfshira në pasqyrat e ZAP-ve, janë në këtë fazë parkim i lirë, parkim për rezidentë dhe pa pagesë.
- Drejtoria respektive në Bashki kur vlerëson se janë plotësuar kushtet për shtrirjen e sistemit të parkimit, propozon për miratim pranë Kryetarit plotesimin, përmirësimin ose shtimin e NDP me nënzonat respektive në mbështetje të kritereve të përcaktuara në kapitujt përkatës. Gjithashtu e njëjta procedurë ndiqet në rastin kur NDP me nënzonat respektive bien ndesh me projektet për zbatim të korsive të dedikuara të transportit publik dhe bicikletave, duke bërë rishikimin e NDP ose nënzonave sipas rastit.
- Bashkia e Tiranës të marrë masat për pajisjen e rezidentëve me autorizimet përkatëse për evidentimin e tyre në zonën e administritimit të parkimit (ZAP) ku banojnë.

ANEKSI NR. 3

Zonat Tarifore dhe Tarifat e Shërbimit të Parkimit të Administruar nga Bashkia e Tiranës

1. Ndarja në Zona Tarifore sipas tipologjive

Zonat Tarifore - me qëllim vendosjen dhe vjetjen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre ndahen si më poshtë:

Zona A: Përfshin zonat më të nxehta ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet të lartë. Një pjesë të rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e Administrës Publike (qëndrore dhe lokale), qendrat e biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, lokalet dhe njësítë e shërbimit etj.

Zona B: Përfshin zonat ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet mesatar, ku qëndrimi i automjeteve në parkim zgjat normalisht 1-3 orë. Në këto zona kohëzgjatja e qëndrimit diktohet nga nevojat e klienteve, në bazë të standartit i jetesës së tyre dhe funksioneve të zonës.

Zona C: Përfshin zonat në zhvillim ku rrjeti rrugor kryesor nuk është shumë i dendur/intensiv. Rrugët sekondare për parkim shfrytëzohet kryesisht nga banorët/rezidentët e zonës dhe në menyrë marzhinale nga vizitorët. Për këtë arsyе niveli i nevojave për vendparkim është krahasimisht më i vogël.

2. Tarifa e Shërbimit të Parkimit

2.1 Tarifa bazë e shërbimit të parkimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës përcaktohet si më poshtë vijon:

(i) Zona A

a. Tarifa për vendparkim në rrugë

100 Leke /ora

b. Tarifa për vedparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 Minuta Falas	
0-3 orë	200
3- 8 orë	500
8- 12 orë	800
12 - 24 orë	500

Autobuzat	
1 orë	500
1- 3 orë	1,000
3- 8 orë	2,000
8-24 orë	3,500

Mungesa e biletë sanksionohet me 3 000 Lekë gjobë.

Për Autobuzat raporti 1me 3

c. Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë (kontrata 1 vje□are)

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	Ditë /Vit	Total Orë	Tarifa/Lekë
Kontrata 1 vit (nga e hëna -të premte)	12	264	3,168	221,760
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	24	365	8,760	438,000
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	12	365	4,380	306,600
Kontrata 1 vit (nga e hena - të premte)	10	264	2,640	198,000
Kontrata 1 vit (nga e hëna - të diel)	10	365	3,650	255,500

Tabela 2 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	22 Ditë /Muaj	Total Orë	Tarifa / Lekë
Paketa 1 mujore	8	22	176	12,300
Paketa 3 mujore	8	66	528	35,000
Paketa 6 mujore	8	132	1056	67,500
Paketa 12 mujore	8	264	2112	132,000

(ii) Zona B

a. Tarifa për vendparkim në rrugë

40 Lekë/ora

b. Tarifa për vendparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 Minuta falas	
0-3 Orë	100

3- 8 Orë	250
8- 24 Orë	300

Autobuzat	
1 Orë	250
1- 3 Orë	500
3- 8 Orë	800
8-24 Orë	1,000

Mungesa e biletës sanksionohet me 1,000 Lekë gjobë.

Për Autobuzat raporti 1 me 3

c. Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1 - Tarifat për vendparkim të rezervuar rrugë

Paketa/Abonim	Orë/Ditë	Ditë /Vit	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3,168	88,704
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8,760	175,200
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4,380	122,640
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2,640	79,200
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3,650	102,200

Tabela 2 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa /Abonim	Orë/Ditë	22 Ditë/Muaj	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Paketa 1 mujore	8	22	176	5,000
Paketa 3 mujore	8	66	528	14,000
Paketa 6 mujore	8	132	1056	27,500
Paketa 12 mujore	8	264	2112	53,000

(iii)Zona C

a. Tarifa për vendparkim në rrugë

20 Lekë /Ora

b. Tarifa për vedparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
--	-------------

0-5 MIN free	
0 - 3 Orë	50
3 - 8 Orë	120
8 - 24 Orë	250

Autobuzat	
1 Orë	150
1 - 3 Orë	300
3 - 8 Orë	300
8 - 24 Orë	500

Mungesa e biletës sanksionohet me 500 Lekë gjobë
Për Autobuzat raporti 1 me 3

c. Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë

Paketa/Abonim	OIrë/Ditë	Ditë /Vit	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3,168	44,352
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8,760	87,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4,380	61,320
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2,640	39,600
Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3,650	51,100

Tabela 2 - Tarifat për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa /Abonim	Orë/Ditë	22 Ditë /Muaj	Total/Orë	Tarifa/Lekë
Paketa 1 mujore	8	22	176	2,500
Paketa 3 mujore	8	66	528	6,600
Paketa 6 mujore	8	132	1056	13,000
Paketa 12 mujore	8	264	2112	25,000

2.2 Në varësi të zhvillimit social-ekonomik të njësive administrative të Bashkisë së Tiranës Kryetari i Bashkisë Tiranës nëpërmjet një urdhërese mund të caktojë nivele të ndryshme të tarifave të shërbimit të parkimit në kufijtë minus 30% / plus 30 % të tarifës bazë.

2.3 Në varësi të ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës në treg Kryetari i Bashkisë Tiranës nëpërmjet një urdhërese mund të caktojë nivele të ndryshme të tarifave të shërbimeve të parkimit në kufijtë minus 30% / plus 30 % të tarifës bazë.

2.4 Të ngarkojë Parking Tirana për vjeljen e tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës.

3. Zonat Tarifore në Qytetin e Tiranës

Ndarja në zona sipas karakteristikave të përcaktuara në pikën 1 të ketij Aneksi, me qëllim vendosjen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë në qytetin e Tiranës është si më poshtë vijon:

